



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT**  
*(Përfundimtar)*

**PËR**

**INSPEKTIMIN NË LIDHJE ME PROCESIN E**  
**RISTRUKTURIMIT**

**KËSHILLI I QARKUT VLORË**

**Tiranë, Prill 2015**

## RAPORT

### **Për kryerjen e inspektimit në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Vlorë.**

#### **Hyrje**

Në muajin shkurt 2015, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mori dijëni se Këshilli i Qarkut Vlorë, me Vendimin nr.41, datë 17.12.2014 "*Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Vlorë*" kishte kryer procesin e ristrukturimit. Disa prej punonjësve ndaj të cilëve është vendosur lirimi nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit të institucionit, e kanë konsideruar aktin administrativ të lirimimit të tyre nga shërbimi civil si të kryer në kundërshtim me procedurën e parashikuar në nenin 50 e vijues të Ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*". Tre prej tyre kërkuan verifikimin e pretendimit të tyre nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Për këto arsye, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2 të Ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, me Vendimin nr. 24, datë 12.03.2015, "*Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Vlorë*", vendosi kryerjen e inspektimit të përgjithshëm në këtë institucion në disa drejtime, si: kuptimi dhe zbatimi i Ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit të sipërcituar, transferimi apo lirimi nga shërbimi civil i punonjësve, nëse këto procedura janë bërë sipas parashikimeve të nenit 50 të ligjit 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar me ligjin 178/2014 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil"* si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014 "*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil*" të Këshillit të Ministrave, Kreu III "*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*".

Në zbatim të Vendimit nr.24, datë 12.03.2015, "*Për kryerjen e inspektimit në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Vlorë*", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u ngrit grupi i inspektimit i përbërë nga Zamira Mujali, Stela Ndoka dhe Ilirjan Osmanlliu, të cilët në datë 26.03.2015 kontaktuan personalisht me personin e kontaktit, \*\*\*\*\* me detyrë specialiste e personelit, arshivës dhe sekretarisë teknike, si dhe me Kryetarin e Këshillit të Qarkut Vlorë, \*\*\*\*\* . Nga ana e personit të kontaktit u vu në dispozicion dokumentacioni i kërkuar, i cili u administrua, u nxorën të dhënat e nevojshme dhe u përgatit materiali në vijim duke u bazuar në objektin dhe qëllimin e inspektimit.

#### **Qëllimi i inspektimit:**

Qëllimi i realizimit të inspektimit është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të Ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar me Ligjin 178/2014 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil"* si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014 "*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin*

*nga shërbimi civil*” të Këshillit të Ministrave, Kreu III “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*”,

- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara e të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil;
- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë edhe detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të Ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” të ndryshuar.

### **Objekti i inspektimit**

1. Si janë kuptuar e zbatuar dispozitat e Ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij, në lidhje me procesin e ristrukturimit (*neni 50 i Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin 178/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*).
2. Kontrolli i procesit të ristrukturimit (*zbatimi i kërkesave të nenit 50 e vijues të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij*) të institucionit, Këshilli i Qarkut Vlorë, në lidhje me mënyrën e zbatimit të kërkesave të ligjit në fjalë, që nga krijimi i komisionit të ristrukturimit i cili shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese, ku nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme e deri në daljen e vendimit përfundimtar të transferimit i cili është kompetencë e njësisë përgjegjëse.
3. Rregullimin e ligjshmërisë në procesin e ristrukturimit nëse vërehen shkelje të procedurës dhe kushteve të përcaktuara në nenin 50 të Ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar me Ligjin 178/2014 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*).
4. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të Ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
  - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përkrahimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion.
  - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr.8549, dt.11.11.1999 “*Statusi nëpunësit civil*” , apo për një periudhë më të vogël sel (një) vit;

- Nëpunës ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se 1 (një) vit në këto pozicione pune;
- Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil;
- Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve;

### **Metodologjia e inspektimit**

Inspektimi përfshiu verifikimin e procesit të ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Vlorë, praktikën e lirimt nga shërbimi civil të nëpunësve që i është shkurtuar pozicioni i punës apo i janë ndryshuar kërkesat e posaçme dhe të përgjithshme, për shkak të ristrukturimit të institucionit bazuar në Vendimin nr.41, datë 17.12.2014 “*Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Vlorë*”.

Me shkresën Nr. 248/1, datë 12.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u njoftua institucioni, Këshilli i Qarkut Vlorë në lidhje me fillimin e inspektimit dhe objektin e tij. Grupi i punës, në datë 26.03.2015 kontaktoi personalisht me personin e kontaktit, \*\*\*\*\*, me detyrë specialiste e personelit, arshivës dhe sekretarisë teknike, si dhe me Kryetarin e Këshillit të Qarkut Vlorë, \*\*\*\*\*. Nga ana e personit të kontaktit u vu në dispozicion dokumentacioni i kërkuar, i cili u administrua, u nxorën të dhënat e nevojshme dhe u përgatit materiali në vijim duke u bazuar në objektin dhe qëllimin e inspektimit.

Në zbatim të programit dhe drejtimit të inspektimit të përcaktuar në Vendimin nr. 24, datë 12.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil u verifikua dhe u trajtua dokumentacioni i mëposhtëm në raport me procedurat ligjore:

- Vendimin nr.41, datë 17.12.2014 i Këshillit të Qarkut Vlorë “*Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Vlorë*”.
- Vendimin nr.3, datë 04.02.2014 i Këshillit të Qarkut Vlorë “*Për miratimin e strukturës të Administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë, për vitin 2014*”.
- Vendimin nr.4, datë 03.03.2014 i Këshillit të Qarkut Vlorë “*Për miratimin e strukturës të Administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë, për vitin 2014*”.
- U administruan aktet e deklarimit të statusit për të gjithë nëpunësit e Këshillit të Qarkut Vlorë, të lëshuara nga Njësia e Personelit.
- Formularët e përshkrimit të punës për të gjithë pozicionet e shërbimit civil sipas strukturës aktuale të vitit 2015.
- Listëpagesat e muajit shkurt 2015 të të gjithë punonjësve të institucionit .
- Vendimet e lirimt nga shërbimi civil të ish nëpunësve civilë të Këshillit të Qarkut Vlorë, për shkak të ristrukturimit.
- Urdhëri nr.1, datë 26.12.2014 i Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë “*Për krijimin e komisionit të ristrukturimit*”
- Urdhërat e emërimit të nëpunësve civilë pas ristrukturimit të institucionit.
- Relacion i Komisionit të Ristrukturimit nr.322, datë 29.01.2015.
- Proces verbali i mbledhjes së Komisionit të Ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Vlorë i datës 26.12.2014 në rastet e lirimt nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit .

## Përmbajtja e raportit:

### **I. Procesi i deklarimit të statusit të punësimit dhe plotësimi i kushteve ligjore për të përfutur statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.**

#### **1. Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e inspektimit .**

Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendos rregulla të qarta për mënyrën e administrimit të shërbimit civil, për të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të tij. Në nenin 2 të këtij ligji, përcaktohet se ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore, por njëkohësisht evidentohen dhe rastet përjashtimore për disa funksione të identifikuar shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit.

Këshilli i Qarkut është krijuar dhe funksionon si organ përfaqësues i Qarkut, mbi bazën e Ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.03.2004, i cili në nenet 5 dhe 6 të tij, e përcakton atë si njësi të qeverisjes vendore e për këtë arsye, ky institucion përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil.

Administrata e Këshillit të Qarkut funksionon mbi bazën e strukturës organizative të miratuar nga Këshilli i Qarkut, sipas parashikimeve të nenit 54 të Ligjit 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ku përcaktohen detyrat dhe kompetencat e Këshillit të Qarkut.

Në rastin konkret, subjekti i inspektimit, funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr. 41, datë 17.12.2014 “Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Vlorë”, ndërsa në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, datë 26.02.2014, Këshilli i Qarkut Vlorë ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr.3, datë 04.02.2014 “Për miratimin e strukturës të Administratës së Qarkut Vlorë, për vitin 2014”.

Sipa strukturës së mësipërme, administrata e Këshillit të Qarkut Vlorë kishte gjithsej **44** pozicione pune. Duke patur parasysh klasifikimin e pozicioneve në shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se në këtë institucion janë **29** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të cilat ndahen në këto kategori:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues janë **3** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”.
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **23** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Përgjegjës sektori/specialist i nivelit të lartë”.
- Nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv janë **3** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “specialist”.

2. Si është kuptuar dhe zbatuar neni 67 i Ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Nisur nga fakti që Këshilli i Qarkut Vlorë është pjesë e shërbimit civil, deklarimi si nëpunës civilë ekzistues për çdo punonjës të këtij institucioni, duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në Lligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neni 67, pikat 3,4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se:

- pika 3, "Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi nëpunësit civil", apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë";
- pika 4 "Nëpunës ekzistues, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji";
- pika 6 "Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit".

Po kështu, në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", Kreu II "Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet", pika 1, është përcaktuar se: "Nëpunës civilë", sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të Ligjit nr.152/2013 dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga Ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Këto janë dispozitat bazë që duhet të mbajë parasysh njësia përgjegjëse për të realizuar drejt detyrimin ligjor të deklarimit të statusit të punësimit.

Për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëse veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil verifikoi dhe analizoi materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si organigramën dhe strukturën e institucionit që ka qenë në fuqi në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit, Vendimi nr.3, datë 04.02.2014 "Për miratimin e strukturës të Administratës së Qarkut Vlorë, për vitin 2014".

Në përfundim të kësaj analize, statusin e punësimit të punonjësve të këtij institucioni sipas strukturës që ka qenë në fuqi në momentin e shtrirjes së efekteve të Ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar mund t'a kategorizojmë në këtë mënyrë:

**a. Nëpunës, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar në Ligjin nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil".**

Nga analiza e dokumentacionit që na është vënë në dispozicion nga institucioni, Këshilli i Qarkut Vlorë, rezulton se nga të gjithë punonjësit e punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, 22 punonjës, janë punësuar në respektim të kërkesave të nenit 13 e vijues të Ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", me procedura konkurimi.

Nga këqyrja e akteve të administruara dhe përmbajtja e tyre rezulton se janë respektuar procedurat ligjore të kërkuara nga ky ligj. Kështu, është shpallur pozicioni i lirë, është krijuar komiteti *ad-hoc*, ka dalë akti i përzgjedhjes dhe i emërimit si dhe akti i konfirmimit si nëpunës civilë për 22 punonjës.

Në respektim të kërkesave të pikës 3 të nenit 67 të Ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*" i ndryshuar si dhe pikës 1 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave "*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil"*, Kreu II "*Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet*", njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësit e administratës të Këshillit të Qarkut.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezultoi se **23** punonjës janë konfirmuar si nëpunës civilë dhe **2** të tjerë nëpunës civilë në periudhë prove. Janë zhvilluar **2** (dy) procedura konkurimi sipas përcaktimeve të nenit 22 e vijues të ligjit 152/2013 "*Për nëpunësin civil*" të ndryshuar dhe Vendimit nr.143, datë 12.03.2014 "*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*".

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse, e ngarkuar nga ligji për të formalizuar aktin e deklarimit të statusit, ka vepruar drejt, kur ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për këto raste.

**b. Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohëshme emërimi pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.**

Nga analiza e materialeve të verifikuara, rezulton se **4** pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion janë plotësuara me akt emërimi të përkohshëm sipas dispozitave të Ligjit 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, duke mos respektuar procedurat e parashikuara në nenin 22 të Ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*" të ndryshuar dhe Vendimin nr.143, datë 12.03.2014 "*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*".

Konkretisht, pozicionet e punës të plotësuara me akte emërimi të përkohshëm janë:

- Përgjegjës i zyrës së programim zhvillimit në Drejtorinë Ekonomike;
- Specialist për infrastrukturën në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Infrastrukturës;
- Specialist për teknologjinë e informacionit në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Infrastrukturës;

- Specialist për arsimin, kulturën, ushqimin dhe Shëndetësinë në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale;

Po nga vetë njësia e burimeve njerëzore të Këshillit të Qarkut Vlorë janë ndërprerë këto marrëdhënie pune si të lidhura në kundërshtim me dispozitat e ligjit për shërbimin civil ; 2 (dy) pozicione rezultojnë të paplotësuara para hyrjes në fuqi të Vendimit nr.41, datë 17.12.2014 “Mbi Strukturën Organizative të Këshillit të Qarkut Vlorë” dhe 2(dy) pozicione janë plotësuar në përputhje me nenin 22 dhe 26 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar dhe Vendimin nr.143, datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”. Për procedurat e konkurimit do të flasim më hollësisht në vijim të raportit të inspektimit.

Duke u nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4 të nenit 67 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nga këqyrja e akteve, rezulton se:

- Në **23** raste nëpunësit civilë, kanë një periudhë më tepër se një vit në atë pozicion pune. Drejtoria e Burimeve Njerëzore sipas përcaktimeve të nenit 67 pika 3 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civilë për të gjitha këto raste.

Punonjësit që kanë përfituar statusin e nëpunësit civil në këtë kategori janë:

*****	Specialist në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit;
*****	Specialist e Arkivës në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit;
*****	Specialist i Urbanistikës në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit;
*****	Specialist hidroteknik në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit ;
*****	Specialist jurist në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit ;
*****	Drejtor i Drejtorisë Ekonomike;
*****	Specialiste Finance në Drejtorinë Ekonomike;
*****	Specialiste Buxheti në Drejtorinë Ekonomike;
*****	Specialiste juriste në Drejtorinë Ekonomike;
*****	Specialiste Turizmi në Drejtorinë Ekonomike;
*****	Specialist për Koordinimin në Drejtorinë Ekonomike;
*****	Specialiste për Monitorimin e Projekteve në Dr.Ekonomike;
*****	Specialiste për Monitorimin e Projekteve në Dr.Ekonomike;
*****	Specialist IT në Drejtorinë e Shërbimeve;
*****	Specialist për Emergjencat Civile në Drejtorinë e Shërbimeve;
*****	Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale;
*****	Specialiste për Çështjet Sociale në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore;
*****	Specialiste e Marrëdhënieve me Jashtë në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore ;
*****	Specialiste në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore;
*****	Kryeinspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës ;
*****	Inspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës ;



\*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*

Inspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës;  
Inspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës;

Nga përmbajtja e akteve të emërimit, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, rezulton se këta punonjës kanë më shumë se një vit që e kryejnë detyrën e tyre funksionale në pozicionet në të cilat janë deklaruar si nëpunës civilë.

**Konkluzion:** Për këto arsye, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ka vepruar në përputhje me ligjin në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit si nëpunës civil për këtë kategori punonjësish.

- Në 2 raste, nëpunësit civil ekzistues, janë punësuar në pozicione pjesë të shërbimit civil, por nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në nenit 67 pika 3 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, sepse kanë një periudhë më pak se një vit në atë pozicion pune. Drejtoria e Burimeve Njerëzore sipas përcaktimeve të nenit 67 pika 4 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civilë në periudhë prove për të gjitha këto raste.

Punonjësit që kanë përfituar statusin e nëpunësit civil në periudhë prove në këtë kategori janë:

\*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*

Specialist-Arkitekt në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit;  
Specialiste finance në Drejtorinë Ekonomike;

Nga përmbajtja e akteve të emërimit, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, rezulton se këta punonjës kanë më pak se një vit që e kryejnë detyrën e tyre funksionale në pozicionet në të cilat janë deklaruar si nëpunës civilë në periudhë prove.

**Konkluzion:** Për këto arsye, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ka vepruar në përputhje me ligjin në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit si nëpunës civil në periudhë prove për këtë kategori punonjësish.

- c. Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me procedura konkurimi sipas përcaktimeve të nenit 22 të Ligjit nr.152/2013 « Për nëpunësin civil » të ndryshuar dhe Vendimit nr.143, datë 12.03.2014 ”Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

Këshilli i Qarkut Vlorë, pas hyrjes në fuqi të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, ka zhvilluar dy procedura konkurimi për të plotësuar pozicionet e punës “Drejtore në Drejtorinë e Financës, Programim Zhvillimit dhe Projekteve” dhe “Specialist për arsimin, kulturën, ushqimin dhe shëndetësinë” në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale.

- Procedura ligjore e ndjekur në konkurimin e zhvilluar për pozicionin “Drejtore në Drejtorinë e Financës, Programim Zhvillimit dhe Projekteve”, në Këshillin e Qarkut Vlorë.

Sipas përcaktimeve të nenit 25 dhe 26 të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 143, datë. 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave, Kreu VI “Lëvizja paralele brenda së njëjtës kategori” dhe Kreu VII “Ngritja në detyrë”, Këshilli i Qarkut Vlorë, nëpërmjet njësisë përgjegjëse ka shpallur në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, shpalljen për pozicionin e lirë të punës “Drejtor në Drejtorinë e Financës, Programim Zhvillimit dhe Projekteve”, nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

Meqënëse brenda afatit të përcaktuar në shpallje (28.10.2014) pozicioni i lirë nuk është plotësuar nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, ai është i vlefshëm për konkurimin e ngritjes në detyrë vetëm për nëpunës civilë sipas përcaktimeve të nenit 26 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 143, date 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave, Kreu VII “Ngritja në detyrë”.

Me Urdhrin nr.3 datë 17.11.2014 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë, bazuar në nenin 22 të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar; Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese” të Këshillit të Ministrave, pika 4 e Kreut VII “Ngritja në detyrë” është krijuar Komisioni i Brendshëm i Ngritjes në Detyrë, i cili, pasi ka kaluar faza e verifikimit paraprak, plotësimi i kërkesave të përgjithshme dhe ato të posaçme të kandidatit nga njësia përgjegjëse, ka bërë vlerësimin e kandidatit fitues \*\*\*\*\* në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, Programim Zhvillimit dhe Projekteve”, sipas proces-verbalit të datës 21.11.2014. Komisioni i Ngritjes në Detyrë, pasi ka përzgjedhur kandidatin fitues, ia ka njoftuar vendimin e përzgjedhjes njësisë përgjegjëse dhe kjo e fundit ka nxjerrë aktin e emërimit nr.18, datë 24.11.2014.

**Konkluzion :** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vlerësuar se në tërësi procedura e konkurimit të mësipërm është kryer në përputhje me nenin 25 dhe 26 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, si dhe me Vendimin nr. 143, datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave, Kreut VII “Ngritja në detyrë”. Gjatë shqyrtimit të praktikave të konkurimit janë konstatuar dhe disa parregullsi të cilat nuk çënojnë në tërësi këtë proces, por do të jenë objekt i përmirësimit të procedurës së konkurimit në të ardhmen. Konkretisht, njësia përgjegjëse ka detyrimin që përpara se të nxjerrë aktin e emërimit të kandidatit fitues duhet të marrë miratimin zyrtar nga ky i fundit si dhe të bëjë shpalljen e kandidatit fitues, përveç se në stendat e informimit të publikut (është realizuar) edhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, sipas parashikimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave, pika 9 dhe 10 e Kreut VII “Ngritja në detyrë”. Një procedurë e tillë nuk është ndjekur në rastin konkret.

- Procedura ligjore e ndjekur në konkurimin e zhvilluar për pozicionin “*specialist për arsimin, kulturën, ushqimin dhe shëndetësinë*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale në Këshillin e Qarkut Vlorë.

Sipas përcaktimeve të nenit 25 të Ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*” të ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014 “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, të Këshillit të Ministrave, Kreu VI “*Lëvizja paralele brenda së njëjtës kategori*”, Këshilli i Qarkut Vlorë, nëpërmjet njësisë përgjegjëse ka shpallur në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, pozicionin e lirë të punës “*specialist për arsimin, kulturën, ushqimin dhe shëndetësinë*” në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale”, nëpërmjet lëvizjes paralele.

Me Urdhër nr.2, datë 17.11.2014 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë, bazuar në nenin 22 e vijues të Ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*” të ndryshuar; Vendimin nr. 143, datë 12.03.2014 “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, të Këshillit të Ministrave, Kreu VI “*Lëvizja paralele brenda së njëjtës kategori*”, është krijuar Komisioni i Përhershëm i Pranimit për Nivelin Ekzekutiv, i cili, pasi ka kaluar faza e verifikimit paraprak, plotësimi i kërkesave të përgjithshme dhe ato të posaçme të kandidatit nga njësisë përgjegjëse, ka bërë vlerësimin e kandidatit fitues \*\*\*\*\* në pozicionin “*specialist për arsimin, kulturën, ushqimin dhe shëndetësinë*” në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale, sipas proces-verbalit të datës 21.11.2014. Komisioni i Përhershëm i Pranimit për Nivelin Ekzekutiv, pasi ka përzgjedhur kandidatin fitues ia ka njoftuar vendimin e përzgjedhjes, njësisë përgjegjëse dhe kjo e fundit ka nxjerrë aktin e emërimit nr.20, datë 24.11.2014.

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vlerësuar se procedura e konkurimit të mësipërm është kryer në përputhje me nenin 25 të Ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” të ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 143, datë 12.03.2014 “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, të Këshillit të Ministrave, Kreut VI “*Lëvizja paralele brenda së njëjtës kategori*”. Gjatë shqyrtimit të praktikave të konkurimit është konstatuar se shpallja e fituesit është bërë vetëm në stendat e informimit të publikut dhe jo në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, siç përcaktohet në Vendimin nr. 143, datë 12.03.2014 “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, të Këshillit të Ministrave, pika 20 e Kreut VI “*Lëvizja paralele brenda së njëjtës kategori*”.

Raporti do të vijojë i detajuar sipas drejtimit të përcaktuar në urdhërin për inspektim të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Për ato raste të cilat vlerësohen se nga ana e njësisë përgjegjëse është vepruar drejt dhe rastet kanë qenë të qarta, nuk do të flitet hollësisht. Në ato raste që do të vlerësohen se procesi i transferimit i parashikuar në nenin 50 të Ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, Vendimin nr.171, dt.26.03.2014 “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*” të Këshillit të Ministrave dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 “*Për përshkrimin dhe klasifikimin*”.

*e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave, është bërë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, do të analizohen hollësisht, duke shprehur qëndrimin përfundimtar që do të mbahet në vendimin e paralajmërimit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, si dhe detyrat që do të lihen për zbatim.*

## **II. Procesi i ristrukturimit i Këshillit të Qarkut Vlorë**

Kriteret bazë mbi të cilat është bërë vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit (*aktet e lirimimit të nëpunësve që u është shkurtuar pozicioni i punës dhe aktet e riemërimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit që plotësojnë kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme për pozicionin e ri të punës sipas përshkrimeve të reja*) nga ana e njësisë përgjegjëse, janë kërkesat e nenit 50 të Ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr.142 datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave, si dhe Vendimit nr.171, dt.26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave dhe konkretisht:

- Përshkrimet e pozicioneve të punës dhe kërkesat e përgjithëshme e të veçanta të këtyre pozicioneve dhe verifikimi i përputhshmërisë së tyre me karakteristikat personale të nëpunësve që janë riemëruar aktualisht në këto pozicione.
- Çertifikimi si nëpunës civilë për nëpunësit e riemëruar pas procesit të ristrukturimit në përputhje me kërkesat e nenit 67 pika 3 dhe 6 të Ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konkluzionet e inspektimit të përgjithshëm do të materializohen në vendimin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

*1/a Struktura organizative e Këshillit të Qarkut Vlorë para procesit të ristrukturimit.*

Nga tërësia e materialeve shkresore të vëna në dispozicion, nga verifikimi i tyre dhe ballafaqimi me ligjin rezultoi se: Sipas strukturës së mëparshme të miratuar me Vendimin nr. 03, datë 04.02.2014 “Për miratimin e Strukturës të Administratës së Qarkut Vlorë, për vitin 2014” të Këshillit të Qarkut Vlorë, numri i përgjithshëm ishte **44** punonjës, nga të cilët **29** pozicione përfshiheshin në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil dhe struktura e aparatit administrativ të institucionit kishte organizimin e mëposhtëm :

- 1. Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Kontrollit të Zhvillimit**, me organikë **1 Drejtor** dhe **5 specialistë** gjithsej **6** nëpunës civil.
- 2. Drejtoria Ekonomike , Programim, Zhvillim dhe Projekte**, me organikë **1 Drejtor** në përbërje të së cilës janë **2** sektorë e konkretisht:
  - 1- Sektori i Financës dhe i Buxhetit, me organikë **1 përgjegjës sektori** dhe **3 specialistë**, gjithsej **4** nëpunës civil.
  - 2- Sektori i Programim dhe Zhvillimit, me organikë **1 përgjegjës sektori** dhe **4 specialistë**, gjithsej **5** nëpunës civil.

3. **Drejtoria e Shërbimeve dhe Infrastrukturës**, me organikë **1 Drejtor** dhe **3 specialistë** gjithsej **4** nëpunës civil.
4. **Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës Bujqësore**, me organikë **1 Kryeinspektor** dhe **3 inspektorë**, gjithsej **4** nëpunës civil.
5. **Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale**, me organikë **1 Drejtor** dhe **4 specialistë** gjithsej **5** nëpunës civil.

Sa sipër rezulton se numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë është **29** (*njëzetëntë*), nga të cilët :

- **3** (*tre*) Drejtorë (*nëpunës civil i kategorisë së mesme drejtuese kategoria II b*) ;
- **23** (*njëzetetre*) përgjegjës sektori dhe specialistë të nivelit të lartë (*nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues kategoria III b*) ;
- **3** (*tre*) specialistë (*kategoria IV b*).

1/b *Struktura organizative e Këshillit të Qarkut Vlorë pas procesit të ristrukturimit, miratuar me Vendimin nr.41, datë 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë.*

Sipas Vendimit nr.41, datë 17.12.2014 “*Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Vlorë*”, që është në fuqi në momentin e inspektimit të përgjithshëm, administrata e Këshillit të Qarkut Vlorë ka gjithsej **14** pozicione pune, nga të cilët **8** pozicione pune në shërbimin civil. Struktura është e organizuar si më poshtë:

1. **Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve**, me organikë **1**(një) Drejtor dhe **4**(katër) specialistë, gjithsej **5** nëpunës civil;
2. **Inspektoriati i Ndërtimit dhe Urbanistikës**, me organikë **1**(një) Kryeinspektor dhe **2**(dy) specialistë-inspektorë, gjithsej **3** nëpunës civilë;

Me miratimin e strukturës së re me Vendimin nr.41, datë 17.12.2014 “*Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Vlorë*”, në këtë institucion janë **8 pozicione pune**, pjesë e shërbimit civil sipas klasifikimit të mëposhtëm:

- **1** pozicion drejtor, nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, klasa II/b;
- **5** pozicione specialist, nëpunës civil të nivelit të ulët drejtues, klasa III/b;
- **2** pozicione specialist, nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, klasa IVb;

Nga krahasimi i strukturave arrihen në konkluzionin se institucioni, Këshilli i Qarkut Vlorë ka kaluar një proces të thellë ristrukturimi (*konstatohet plotësimi i dy kërkesvet ligjore për të pasur një proces ristrukturimi: shkurtimi i numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe ndryshimi i strukturës organizative*). Në strukturën aktuale nuk ekzistojnë **3** (*tre*) Drejtor; **2** (*dy*) sektorë e **1** (*një*) inspektoriat, për rrjedhojë është shkurtuar numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë nga **29** (*njëzetëntë*) janë aktualisht **8** (*tetë*), pozicionet që konkretisht i kemi cituar më lart.

- *Respektimi i kërkesave ligjore për përshkrimin e punës.*

Sipas parashikimeve të nenit 50 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave, është njësia përgjegjëse ajo që drejton gjithë procesin nga ana ligjore. Ajo krijon komisionin e ristrukturimit dhe ka detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për lirim nga shërbimi civil të nëpunësve që i është shkurtuar pozicioni i punës dhe u ka ndryshuar përshkrimi i punës, pas propozimit të bërë nga komisioni i ristrukturimit.

Përshkrimet e reja të punës i kanë paraprirë procesit të ristrukturimit. Sipas pikës 14 “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës” të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave, përshkrimet e reja të punës janë bërë sepse ka ndryshuar mënyra e organizimit të Këshillit të Qarkut Vlorë si pasojë e ristrukturimit dhe janë një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave kryesore dhe përgjegjësive kryesore të pozicionit të punës, për shkak se duhet vlerësuar pozicioni i punës në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e reja. Një numër më i reduktuar nëpunësish civilë do të kryejnë detyrat në funksion të arritjes së misionit për të cilin është krijuar institucioni i këshillit të qarkut. Pra, nëpunësit e emëruar pas procesit të ristrukturimit do të realizojnë detyrat që më parë i kanë realizuar **29** (njëzetëntë) nëpunës civilë e për rrjedhojë përzgjedhja e tyre duhej bërë mbi bazën e kërkesave për një nivel më të lartë profesional, me aftësi të mira organizative dhe menaxhuese, si dhe përvojën e duhur për zgjidhjen e problemeve.

Këto rezultojnë se kanë qenë kriteret që janë mbajtur parasysh nga komisioni i ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse në marrjen e vendimeve përfundimtare të emërimit në pozicionet e mbetura pas procesit të ristrukturimit.

- *Respektimi i kërkesave ligjore për zbatimin e nenit 50 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimit nr.171, dt.26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave.*

Drejtuesi i njësisë organizative përgjegjëse i Këshillit të Qarkut Vlorë, bazuar në Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave, Kreu IV “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës” në funksion të procesit të ristrukturimit dhe në zbatim të Vendimit nr.41, datë 17.12.2014, “Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Vlorë”, ka hartuar përshkrimet e punës.

Përshkrimet e reja të punës janë bërë duke riklasifikuar pozicionet e mbetura në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e reja dhe janë një përmbledhje e misionit dhe qëllimit të përgjithshëm të Këshillit të Qarkut.

Nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, konstatohet se në tërësi i gjithë procesi i ristrukturimit është kryer në përputhje me ligjin. Vendimet e lirim si dhe riemërimit të nëpunësve civilë aktualë janë hartuar në përputhje me nenin 50 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Vendimin nr.171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e

*pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave, më konkretisht:*

### **III. Procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore në marrjen e vendimit përfundimtar të riemërimit në shërbimin civil të nëpunësve pas ristrukturimit të institucionit, komenti ligjor dhe konkluzionet për secilin rast.**

Me Urdhrin nr.1, datë 26.12.2014 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë “*Për krijimin e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit*”, dalë në bazë e për zbatim të Vendimit nr.41, datë 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë “*Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Vlorë*”, nenit 50 të Ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, Vendimit nr.171, dt.26.03.2014 “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*” të Këshillit të Ministrave dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014 “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimit nr.3, datë 14.04.2014 “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit*” të Departamentit të Administratës Publike, është krijuar Komisioni i Ristrukturimit.

Komisioni i Ristrukturimit pasi ka përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 50 të Ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, Vendimin nr.171, dt. 26.03.2014 “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*” të Këshillit të Ministrave, ka bërë propozimet përkatëse para njësisë të personelit për sistemimin në punë të punonjësve më të përshtatshëm.

Për këtë është mbajtur si kriter thelbësor fakti që, gjithë kompetencat dhe funksionet e Këshillit të Qarkut (të cilat janë të pandryshuara, pasi nuk kemi ndryshime të qëllimit, funksionit apo kompetencave të institucionit) do të plotësohen me një numër shumë më të pakët punonjësish. Kjo situatë ka diktuar shkrirjen e drejtorive, uljen e nivelit dhe kategorive të vendeve të punës dhe bashkimin e disa funksioneve të mëparshme në një pozicion pune.

Kjo ka sjellë si pasojë edhe konkluzionin e Komisionit të Ristrukturimit, që pas ristrukturimit, në punë do të mbaheshin punonjësit më të kualifikuar dhe më me eksperiencë, në mënyrë që të ishin të aftë të përshtateshin me gjëndjen e re të punëve, ku një nëpunës i vetëm duhej të përballonte punën e disa nëpunësve, sipas strukturës së mëparshme.

Po kështu, Komisioni i Ristrukturimit, me anë të relacionit nr.322 datë 29.01.2015, drejtuar njësisë përgjegjëse (*Njësisë së Burimeve Njerëzore*), bazuar në pikën 7 të nenit 50 të Ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, propozon trajtimin financiar për të gjithë nëpunësit të cilët do të largohen për shkak të ristrukturimit, sipas vjetërsisë në atë pozicion i cili shkurtohet. Për më tepër nëpunësit janë njoftuar 1 muaj përpara për fillimin e procedurës së lirit nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit.

Gjithë procedura e ndjekur më sipër është konkluduar me Vendimin nr.1 datë 29.01.2015 të Komisionit të Ristrukturimit, i cili ka vendosur lirin nga detyra të nëpunësve civilë për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Vendimi i mësipërm i Komisionit të Ristrukturimit ka dalë në kapërcim të kompetencave ligjore, për arsye se ky i fundit nuk mund të vendosë, por të propozojë lirin nga shërbimi civil. Kjo kompetencë e tij është parashikuar në pikën 3 të nenit 50 të Ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, Vendimin nr.171, datë 26.03.2014 “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*” të Këshillit të

Ministrave. Vendimi përfundimtar për lirim nga shërbimi civil sipas dispozitave të mësipërme merret nga njësia përgjegjëse siç dhe është vepruar konkretisht.

Nisur nga gjithë sa u tha më sipër, njësia e personelit ka pranuar propozimet e Komisionit të Ristrukturimit dhe ka nxjerrë aktet e riemërimit pas restrukturimit. Nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil u konstatua se në rastin kur ka pasur ulje në detyrë të punonjësit, nuk është marrë mendimi i tij me shkrim për pranimin ose refuzimin e pozicionit të ofruar siç përcaktohet në pikën 19 dhe 20, Kreu III “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe restrukturimit të institucionit*” të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil*”, por kjo parregullsi nuk e bën të pavlefshëm vendimin e emërimit, i cili përveç sa sipër, ka dalë në përputhje me kërkesat e nenit 50 të Ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Vendimit nr.171 datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil*”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe restrukturimit të institucionit*” dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014 “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” të Këshillit të Ministrave.

Njësia përgjegjëse ka një perceptim të gabuar në lidhje me normat ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës të punonjësve të Inspektoriatit të Ndërtimit dhe Urbanistikës. Këto pozicione pune, bazuar në nenin 2 të Ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” të ndryshuar dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” Lidhja nr.1 “*Lista e institucioneve të administratës shtetërore*” janë pozicione të cilat përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil. Në këtë kontekst aktet e emërimit të punonjësve të këtij inspektoriatit kanë dalë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e konkretisht me nenin 22 të Ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” të ndryshuar si dhe Vendimin nr.143 datë 12.03.2014 “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*” të Këshillit të Ministrave. Më poshtë, vijojmë me aktet e emërimit pas restrukturimit:

1. \*\*\*\*\*, me aktin administrativ nr.01, datë 29.01.2015 është emëruar, në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve (*nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, kategoria II b; procedura konkurimit bazuar në nenin 22 të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar*). Më parë nëpunësja ka qenë me detyrë përgjegjëse e zyrës së Financës dhe Buxhetit në Drejtorinë Ekonomike, Programim Zhvillimit dhe Projekteve (*emëruar me Urdhrin nr.04, datë. 02.03.2014 “komandim në detyrë”*); Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, Programim Zhvillim dhe Projekteve (*emëruar me Urdhërin nr.18, datë 24.11.2014” komandim në detyrë*) dhe akti i deklarimit të statusit nr.15; datë 11.07.2014 si *specialist finance*).  
Nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca ekonomike, mbi 5 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.
2. \*\*\*\*\*, me aktin administrativ nr.02, datë 29.01.2015 është emëruar në detyrën e specialistes së personelit, arshivës, sekretarisë teknike dhe magazinës (*nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria III b*). Më parë nëpunësi ka qenë në detyrën e specialistes së personelit, informacionit, protokollit dhe arshivës (*emëruar me Urdhrin e Brendshëm*



nr.7 datë 18.06.2014 “Për zbatimin e titullit ekzekutiv dhe akti i deklarimit të statusit nr.7; datë 11.07.2014; kategoria IIIb).

Nëpunësja \*\*\*\*\* plotëson kërkesat e posaçme (arsimi i lartë shkenca ekonomike) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës, për më tepër e ka ushtruar dhe më parë këtë detyrë.

3. \*\*\*\*\* , me aktin administrativ nr.03, datë 29.01.2015 është emëruar në detyrën e specialistes për arsimin, kulturën, turizmin dhe çështjet sociale në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria III b; nëpunëse civile në periudhë prove). Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë në të njëjtën detyrë, por në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale (emëruar me aktin administrativ nr.20, datë 24.11.2014; procedura konkurimi bazuar në nenin 22 të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar).  
Nëpunësja \*\*\*\*\* plotëson kërkesat e posaçme (arsimi i lartë shkenca shoqërore, fakulteti i mësuesisë) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.
4. \*\*\*\*\* , me aktin administrativ nr.04, datë 29.01.2015 është emëruar në detyrën e juristes në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria III b). Më parë ka qenë nëpunëse civile në të njëjtin pozicion, por në Drejtorinë Ekonomike, Programim, Zhvillimit dhe Projekteve.  
Nëpunësja \*\*\*\*\* plotëson kërkesat e posaçme (Fakulteti juridik, njohuri të gjuhës së huaj anglisht) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.
5. \*\*\*\*\* , me aktin administrativ nr.05, datë 29.01.2015 është emëruar në detyrën e specialistit për emergjencat civile, mjedisin, ushqimin dhe shëndetësinë në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria III b). Më parë ka qenë nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale (emëruar rregullisht pas procedurave konkurruese, me Urdhrin nr.2/1, datë 05.04.2010 dhe akti i deklarimit të statusit nr.12, date 16.06.2014; kategoria IIb).
6. \*\*\*\*\* , me aktin administrativ nr.06, date 29.01.2015 është emëruar në pozicionin “ Kryeinspektor” në Inspektoriatin Ndërtimor dhe Urbanistik të Këshillit të Qarkut Vlorë (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria III b). Akti administrativ i sipërcituar nuk ka dalë sipas përcaktimeve të nenit 22 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, si dhe Vendimit nr.143 datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese” të Këshillit të Ministrave, për shkak se institucioni bën një interpretim të gabuar në lidhje me rregullimin ligjor të marrëdhënies së punësimit për punonjësit e këtij inspektoriati.
7. \*\*\*\*\* , me aktin administrativ nr.07, date 29.01.2015 është emëruar në pozicionin “inspektor” në Inspektoriatin Ndërtimor dhe Urbanistik të Këshillit të Qarkut Vlorë (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV b). Akti administrativ i sipërcituar nuk ka dalë sipas përcaktimeve të nenit 22 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar si dhe Vendimit nr.143 datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të

*periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese” të Këshillit të Ministrave, për shkak se institucioni bën një interpretim të gabuar në lidhje me rregullimin ligjor të marrëdhënies së punësimit për punonjësit e këtij inspektoriatit.*

8. *\*\*\*\*\**, me aktin administrativ nr.08, datë. 29.01.2015 është emëruar në pozicionin “inspektor” në Inspektoriatin Ndërtimor dhe Urbanistik të Këshillit të Qarkut Vlorë (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV b). Akti administrativ i sipërcituar nuk ka dalë sipas përcaktimeve të nenit 22 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, si dhe Vendimit nr.143 datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese” të Këshillit të Ministrave, për shkak se institucioni bën një interpretim të gabuar në lidhje me rregullimin ligjor të marrëdhënies së punësimit për punonjësit e këtij inspektoriatit.

Sa sipër konstatohet se, kriteret e ndjekura (*formularët e përshkrimit të punës*) nga komisioni i ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse, bazuar në kompetencat ligjore të parashikuara në nenin 50 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimin nr.171 datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit” dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave, në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të emërimit, kanë qenë në funksion të mënyrës së re të organizmit të Këshillit të Qarkut Vlorë si pasojë e ristrukturimit, realizimit të misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave dhe përgjegjësi kryesore. Për këtë arsye është vendosur që nëpunësit që janë mbajtur dhe rriemëruar të kenë një nivel të lartë profesional, të kenë aftësi organizative, menaxhuese, të kenë përvojë në zgjidhjen e problemeve (*janë mbajtur nëpunës që kanë pasur para ristrukturimit të njëjtat pozicione pune dhe kanë ushtruar të njëjtat funksione, përveç rastit të drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, i cili është ulur në detyrën e specialistit*).

#### **IV. Procedura ligjore e ndjekur nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore në marrjen e vendimit përfundimtar të lirit nga shërbimi civil i nëpunësve që i është shkurtuar pozicioni i punës për shkak të ristrukturimit të institucionit, komentë ligjor dhe konkluzionet për secilin rast.**

Me Urdhrin nr. 1, datë 26.12.2014 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë, “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të Mbylljes apo Ristrukturimit” është ngritur Komisioni i Ristrukturimit sipas përcaktimeve të nenit 50 e vijues të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; Vendimit nr.171, dt.26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave. Komisioni i Ristrukturimit, bazuar në kompetencat e parashikuara në ligj ka filluar ushtrimin e funksionit të tij për zbatimin e procedurave ligjore për lirin e nëpunësve nga shërbimi civil, vendet e punës të cilëve kanë pësuar shkurtim apo riorganizim.

Nga grupi i inspektimit u konstatua se të gjithë aktet e lirimit të nxjerra nga njësia përgjegjëse kanë dalë në përputhje me kërkesat e nenit 50 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimin nr.171 datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit” dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave. Konkretisht nëpunësve, të cilëve u është shkurtuar pozicioni i punës janë njoftuar 1 muaj përpara për fillimin e kësaj procedure dhe në përputhje me vjetërsinë i kanë dhënë të drejtën e dëmshpërblimit sipas përcaktimeve të pikës 7 të nenit 50 të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; Vendimit nr.171, dt.26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave. Sipas Vendimit nr.1, datë 29.01.2015 të Komisionit të Ristrukturimit, nëpunësit të cilët janë propozuar për tu liruar nga detyra për shkak të ristrukturimit të institucionit janë si më poshtë:

1. \*\*\*\*\* , ish nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, i komanduar në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Kontrollit të Zhvillimit me Urdhërin nr. 4, datë 03.03.2014. Komandimi në detyrën e mësipërme është bërë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 26 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar dhe Vendimit nr. 143, date 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese” të Këshillit të Ministrave, pika 9 dhe 10 e Kreut VII “Ngritja në detyrë”. Akti i çertifikimit të statusit të nëpunësit \*\*\*\*\* nuk duhej të bëhej në pozicionin e drejtorit, por në pozicionin e specialistit arkitekt sipas përcaktimeve të nenit 67 pika 3 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar . Për rrjedhojë, njësia përgjegjëse ka gabuar në nxjerrjen e vendimit nr.14, datë 2.02.2015, sepse lirimi i nëpunësit \*\*\*\*\* duhet të bëhej “*de jure*” në pozicionin e specialistit dhe jo “*de facto*” në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Kontrollit të Zhvillimit, në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Infrastrukturës. Komandimi në detyrën e mësipërme është bërë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 26 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar dhe Vendimit nr. 143, date 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese” të Këshillit të Ministrave, pika 9 dhe 10 e Kreut VII “Ngritja në detyrë”.  
Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41, datë 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë nuk ekziston as Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Kontrollit të Zhvillimit dhe as pozicioni i punonjësit \*\*\*\*\* si specialist.
2. \*\*\*\*\* , ish nëpunëse civile e nivelit të ulët drejtues , me detyrë specialiste e Urbanistikës Studimore, Mjedisit dhe Gjeodezisë, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Kontrollit të Zhvillimit (kategoria III b) .  
Aktin e çertifikimit të statusit nr.11, datë 11.07.2014, \*\*\*\*\* e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.8, datë 02.02.2015 të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësës nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me

- Vendimin nr.41 datë. 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë, nuk ekziston as Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Kontrollit të Zhvillimit dhe as pozicioni i punonjës.
3. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues me detyrë specialist hidroteknik në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Kontrollit të Zhvillimit (*kategoria III-b*). Aktin e certifikimit të statusit nr.10, datë 11.07.2014, \*\*\*\*\* e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.7, datë 02.02.2015 të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41 datë 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë, nuk ekziston as Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Kontrollit të Zhvillimit dhe as pozicioni i punonjësit.
  4. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil e nivelit të ulët drejtues, me detyrë specialist arkitekt në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Kontrollit të Zhvillimit (*kategoria III-b*). Aktin e certifikimit të statusit nr.8, datë 11.07.2014, \*\*\*\*\* e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.12, datë 02.02.2015 të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41 datë 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë, nuk ekziston as Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Kontrollit të Zhvillimit dhe as pozicioni i punonjësit.
  5. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civile e nivelit të ulët drejtues, me detyrë specialiste e Urbanistikës Ligjore në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Kontrollit të Zhvillimit (*kategoria III-b*). Aktin e certifikimit të statusit nr.6, datë 11.07.2014, \*\*\*\*\* e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.13, datë 02.02.2015 të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41 datë 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë, nuk ekziston as Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Kontrollit të Zhvillimit dhe as pozicioni i punonjës.
  6. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civile e nivelit të ulët drejtues, me detyrë specialiste buxheti në Drejtorinë Ekonomike, Programim Zhvillim dhe Projekteve (*kategoria III-b*) Aktin e certifikimit të statusit nr.16, datë 11.07.2014, \*\*\*\*\* e ka në të njëjtin pozicion pune. Me vendimin nr.20, datë 02.02.2015 të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41 datë. 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë, nuk ekziston as Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Kontrollit të Zhvillimit dhe as pozicioni i punonjës.
  7. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civile e nivelit të ulët drejtues, me detyrë specialiste finance, në Drejtorinë Ekonomike, Programim, Zhvillim dhe Projekteve (*kategoria III-b*) . Aktin e certifikimit të statusit nr.1, datë 11.07.2014, \*\*\*\*\* e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.18, datë 02.02.2015 të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41 datë 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë, nuk ekziston as Drejtoria Ekonomike, Programim, Zhvillim dhe Projekteve dhe as pozicioni i punonjës.
  8. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civile e nivelit të ulët drejtues, me detyrë specialiste turizmi në Drejtorinë Ekonomike, Programim, Zhvillim dhe Projekteve (*kategoria III-b*). Aktin e certifikimit të statusit nr.9, datë 11.07.2014, \*\*\*\*\* e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.11, datë 02.02.2015 të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41 datë. 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë, nuk ekziston as Drejtoria Ekonomike, Programim, Zhvillim dhe Projekteve dhe as pozicioni i punonjës.

9. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, me detyrë specialist për Koordinimin dhe Statistikën në Drejtorinë Ekonomike, Programim, Zhvillim dhe Projekteve (*kategoria III-b*). Në këtë pozicion pune është emëruar në zbatim të Vendimit nr.10, datë 21.07.2014 “Për zbatimin e titullit ekzekutiv”. Me vendimin nr. 16 datë 02.02.2015 të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41 datë 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë, nuk ekziston as Drejtoria Ekonomike, Programim, Zhvillim dhe Projekteve dhe as pozicioni i punonjësit.
10. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civile e nivelit të ulët drejtues, me detyrë specialiste për hartimin dhe monitorimin e projekteve në Drejtorinë Ekonomike, Programim, Zhvillim dhe Projekteve (*kategoria III-b*). Aktin e certifikimit të statusit nr.13, datë 11.07.2014, \*\*\*\*\* e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.04, datë 02.02.2015 të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësës \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41 datë 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë, nuk ekziston as Drejtoria Ekonomike, Programim, Zhvillim dhe Projekteve dhe as pozicioni i punonjësës.
11. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civile e nivelit të ulët drejtues, me detyrë specialiste për hartimin dhe monitorimin e projekteve në Drejtorinë Ekonomike, Programim, Zhvillim dhe Projekteve (*kategoria III-b*). Aktin e certifikimit të statusit nr.08, datë 11.07.2014, E.Boraku e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.06, datë 02.02.2015 të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësës \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41 datë 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë, nuk ekziston as Drejtoria Ekonomike, Programim, Zhvillim dhe Projekteve dhe as pozicioni i punonjësës.
12. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, i komanduar në detyrën e Drejtorit të Shërbimeve dhe Infrastrukturës me Urdhërin nr. 4, datë 03.03.2014. Komandimi në detyrën e mësipërme është bërë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 26 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar dhe Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave, pika 9 dhe 10 e Kreut VII “Ngritja në detyrë”. Akti i certifikimit të statusit të nëpunësit \*\*\*\*\* nuk duhet të bëhet në pozicionin e drejtorit, por në pozicionin e specialistit të teknologjisë së informacionit sipas përcaktimeve të nenit 67 pika 3 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar . Për rrjedhojë, njësia përgjegjëse ka gabuar në nxjerrjen e vendimit nr.3, datë 02.02.2015, sepse lirimi i nëpunësit \*\*\*\*\* duhet të bëhet “*de jure*” në pozicionin e specialistit dhe jo “*de facto*” në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Infrastrukturës. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41 datë 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë nuk ekziston as Drejtoria e Shërbimeve dhe Infrastrukturës dhe as pozicioni i punonjësit \*\*\*\*\* si specialist.
13. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, me detyrë specialist për emergjencat civile, mjedis, energji dhe bujqësi gjeodezi në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Infrastrukturës. Aktin e certifikimit të statusit nr.3, datë 11.07.2015, nëpunësi e ka në pozicionin e mësipërm. Me vendimin nr.01, datë 02.02.2015 të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41 datë 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut

Vlorë, nuk ekziston as Drejtoria e Shërbimeve dhe Infrastrukturës dhe as pozicioni i punonjësit.

14. \*\*\*\*\*, ish nëpunëse civile e nivelit të ulët drejtues, me detyrë specialiste për marrëdhëniet me jashtë dhe informacionin në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale (*kategoria III-b*). Aktin e çertifikimit të statusit nr. 05, datë 11.07.2014, \*\*\*\*\* e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr. 02, datë 02.02.2015 të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësës \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41 datë. 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë, nuk ekziston as Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale dhe as pozicioni i punonjësës.
15. \*\*\*\*\*, ish nëpunëse civile e nivelit të ulët drejtues, me detyrë specialiste për çështjet sociale në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale (*kategoria III-b*). Aktin e çertifikimit të statusit nr.25, datë 11.07.2014, \*\*\*\*\* e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.15, datë 02.02.2015 të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësës \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41 datë. 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë, nuk ekziston as Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale dhe as pozicioni i punonjësës.
16. \*\*\*\*\*, ish nëpunëse civile e nivelit të ulët drejtues, me detyrë specialiste për burimet njerëzore, personelin dhe arkivën në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale (*kategoria III-b*). Aktin e çertifikimit të statusit nr.27, datë 11.07.2014, \*\*\*\*\* e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.21, datë 24.03.2015 të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësës \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41 datë. 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë, nuk ekziston Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale; funksionet e këtij pozicioni kryhen nga specialistja e personelit, arkivës, sekretarisë teknike dhe magazinës pranë Drejtorisë ekonomike dhe Shërbimeve, nëpunësja \*\*\*\*\*.
17. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, me detyrë kryeinspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës (*kategoria III-b*). Aktin e çertifikimit të statusit nr.18, datë 11.07.2014, \*\*\*\*\* e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.09, datë 02.02.2015 të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41, datë 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë nuk ekziston as Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës dhe as pozicioni i punës i nëpunësit.
18. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv (*kategoria IV-b*), me detyrë inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës. Aktin e çertifikimit të statusit nr.17, datë 11.07.2014, \*\*\*\*\* e ka në pozicionin e inspektorit pranë IMT. Me vendimin nr.19, datë 02.02.2015 të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41, datë 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë nuk ekziston as Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës dhe as pozicioni i punës i nëpunësit.
19. \*\*\*\*\*, ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv (*kategoria IV-b*), me detyrë inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës. Aktin e çertifikimit të statusit nr.19, datë 11.07.2014, \*\*\*\*\* e ka në pozicionin e inspektorit pranë IMT. Me vendimin nr.05, datë 02.02.2015 të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësit

\*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41, datë 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë nuk ekziston as Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës dhe as pozicioni i punës i nëpunësit.

20. \*\*\*\*\* , ish nëpunës civil i nivelit ekzekutiv (*kategoria IV-b*), me detyrë inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës. Aktin e certifikimit të statusit nr.26, datë 11.07.2014, \*\*\*\*\* e ka në pozicionin e inspektorit pranë IMT. Me vendimin nr.10, datë 02.02.2015 të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësit \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.41, datë 17.12.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë nuk ekziston as Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës dhe as pozicioni i punës i nëpunësit.

**V. Analiza e disa parregullsive që lidhen me kuptimin dhe zbatimin jo të drejtë të dispozitave të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Vendimin nr.171 datë 26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", të Këshillit të Ministrave, Kreu III "Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit" dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" të Këshillit të Ministrave, Vendimit nr. 143; date 12.03.2014 "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese", të Këshillit të Ministrave, pika 9 dhe 10 e Kreut VII "Ngritja në detyrë", të konstatuara gjatë inspektimit të përgjithshëm në Këshillin e Qarkut Vlorë.**

Në kuadër të detyrës së caktuar, për verifikimin e mënyrës së zbatimit të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil kontrolloi procedurat e zhvillimit të konkurrenive: Shpallja për plotësimin e pozicionit "Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, Programim Zhvillim dhe Projekteve" në Këshillin e Qarkut Vlorë është bërë në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike. Pas shpalljes, me Urdhrin nr. 03, datë.17.11.2014 të titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të brendshëm për ngritje në detyrë në shërbimin civil për kategoritë e mesme drejtuese" është krijuar komisioni i brendshëm bazuar në pikën 3 të nenit 25 të të Ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar dhe Vendimin nr.143, datë 12.03.2014 "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese", të Këshillit të Ministrave, pika 9 dhe 10 e Kreut VII "Ngritja në detyrë".

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konstaton se nga ana e institucionit gjatë zhvillimit të procedurës së konkurimit nuk është respektuar pika 5 e Vendimit nr.143, datë 12.03.2014 "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese", të Këshillit të Ministrave , që përcakton detyrimin e njësisë së qeverisjes vendore të bëjë shpalljen në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit". Mosrespektimi i procedurës së mësipërme ka sjellë mosrespektimin e afateve të përcaktuara në pikën 7 dhe 9 të vendimit të mësipërm. Po kështu krijohet bindja se mosmarrja pjesë e konkurrenteve në këtë procedurë konkurimi mund të ketë ardhur dhe për shkak se konkurentja e vetme për këtë pozicion është

nëpunëse ekzistuese në Këshillin e Qarkut Vlorë. Ky konstatim vlen dhe për konkurimin e zhvilluar për pozicionin e punës ”specialist për arsimin, kulturën, ushqimin dhe shëndetësinë” në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale në Këshillin e Qarkut Vlorë.

Aktet e emërimit të kandidatëve fitues janë nxjerrë nga njësia përgjegjëse jo sipas përcaktimeve të Vendimit nr.143, datë 12.03.2014 ”Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, pikës 9 dhe 10, KREU VII “Ngritja në Detyrë”. Kandidatëve fitues nuk u është marrë miratimi zyrtar dhe nuk është bërë shpallja e tyre në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” .

Nga ana e njësisë përgjegjëse të Këshillit të Qarkut Vlorë ka një kuptim të gabuar të pikës 7 të nenit 50 të Ligjit 152/2013 ”Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave. Aktet e lirit nga shërbimi civil për shkak të dispozitave të mësipërme si dhe dëmshpërblimi në përputhje me vjetërsinë në punë bëhet në pozicionin që nëpunësi civil është certifikuar sipas nenit 67 pika 3 dhe 4 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Për këtë arsye, aktet e lirit për nëpunësit civil \*\*\*\*\* në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Kontrollit të Zhvillimit në Këshillin e Qarkut Vlorë dhe \*\*\*\*\* në pozicionin e Drejtorit të Shërbimeve dhe Infrastrukturës, janë nxjerrë jo sipas përcaktimeve ligjore të cituara më sipër. Pra, dëmshpërblimi financiar për nëpunësit e mësipërm në përputhje me vjetërsinë në punë sipas përcaktimeve të pikës 7 të nenit 50 të Ligjit 152/2013 ”Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 dt.26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, për \*\*\*\*\* të bëhet në pozicionin “specialist” në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Kontrollit të Zhvillimit në Këshillin e Qarkut Vlorë dhe për punonjësin \*\*\*\*\* në pozicionin “specialist” në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Infrastruktues në Këshillin e Qarkut Vlorë.

Marrëdhëniet e punës të punonjësve të Inspektoriatit të Ndërtimit dhe Urbanistikës rregullohen nga Ligji 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Më konkretisht, sipas përcaktimeve të nenit 2 të ligjit të mësipërm dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave, Lidhjes nr.1 “Lista e Institucioneve të Administratës Shtetërore” botuar në Fletoren Zyrtare nr.37, datë 25.03.2014, kjo njësi dhe kjo kategori nëpunësish ushtron një funksion publik e për këtë arsye hyn në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

Edhe në këtë rast, njësia përgjegjëse ka një koncept të gabuar në lidhje me rregullimin ligjor të kësaj marrëdhënie pune. Për këtë arsye aktet e emërimit të Kryeinspektorit dhe 2(dy) inspektorëve të kësaj njësie janë rregulluar nga dispozitat e Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë. Këto akte emërimi duhet të konstatohen si të parregullta, sepse kanë dalë në kundërshtim me nenin 22 e vijues të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe Vendimin nr. 143, date 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave. Për rrjedhojë duhet të revokohen, akti i emërimit nr.6 datë 29.01.2015; akti i emërimit nr. 7 dhe 8, datë 29.01.2015 dhe të shpallen si pozicione të lira, për t’i hapur rrugë fillimit të procedurave të konkurimit sipas përcaktimeve të



nenit 22 e vijues të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe Vendimit nr. 143, date 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave.

Riemërimet e nëpunësve civilë në pozicione të një kategorie të barabartë ose më të ulët janë bërë pa marrë paraprakisht deklarimin me shkrim të nëpunësit nëse pranon ose jo detyrën e re (rasti \*\*\*\*\*), siç përcaktohet në pikën 20, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”; të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”. Gjithsesi, këto parregullsi nuk çenojnë në tërësi procesin e ristrukturimit. Ky proces ka qenë i kushtëzuar nga Ligji 160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015” dhe në këtë kontekst është dashur të veprohet me shpejtësi për të zbatuar procedurën e ristrukturimit sipas kërkesave ligjore, por dhe respektuar të drejtat e nëpunësve civilë të prekur nga procesi (janë ndërprerë në tërësi 20 marrëdhënie pune). Fillimi dhe përfundimi i procesit në një kohë të shpejtë është dhe shkak i lejimit të parregullsive të karakterit objektiv (nuk çenojnë përmbajtjen e procesit) si pasojë e kuptimit të gabuar të ligjit për shërbimin civil dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në bazë e zbatim të tij. Ky ligj ka një zhvillim dinamik dhe implementimi i tij do të kërkojë kohë dhe trajnime të vazhdueshme të cilat do të jenë të domosdoshme për nëpunësit e Këshillit të Qarkut Vlorë.

## **KONKLUZION:**

Nisur nga parregullsitë e konstatuara, të cilat nuk çenojnë ligjshmërinë në tërësi të procesit, sepse mund të konsiderohen si të karakterit objektiv dhe që nuk kanë sjellë vendimmarrje të gabuar, lind domosdoshmëria e korrigjimit të tyre në të ardhmen :

1. Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë të revokojë aktin e emërimit nr.6, 7 dhe 8 datë 29.01.2015 që i përket punonjësve: \*\*\*\*\* me detyrë Kryeinspektor i Inspektoriatit të Ndërtimit dhe Urbanistikës; \*\*\*\*\* me detyrë inspektor në Inspektoriatit të Ndërtimit dhe Urbanistikës dhe \*\*\*\*\* me detyrë inspektor në Inspektoriatit të Ndërtimit dhe Urbanistikës të Këshillit të Qarkut Vlorë.
2. Njësia përgjegjëse të shpallë pozicione të lira pune atë të Kryeinspektorit dhe 2 (dy) inspektorëve të Inspektoriatit të Ndërtimit dhe Urbanistikës dhe të vijojë me procedurat e konkurimit sipas përcaktimeve të nenit 22 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar dhe Vendimit nr.243, datë 18.03.2015 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave.
3. Të bëhet dëmshpërblimi financiar për nëpunësin \*\*\*\*\* dhe nëpunësin \*\*\*\*\* në përputhje me vjetërsinë në punë sipas përcaktimeve të pikës 7 të nenit 50 të ligjit 152/2013 ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 dt.26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave: për \*\*\*\*\* në pozicionin “specialist” në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Kontrollit të

Zhvillimit në Këshillin e Qarkut Vlorë dhe për punonjës in \*\*\*\*\* në pozicionin “*specialist*” në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Infrastruktues në Këshillin e Qarkut Vlorë.

4. Njësia përgjegjëse të marrë mendimin me shkrim të gjithë nëpunësve të emëruar pas ristrukturimit sipas përcaktimeve të pikës 20, Kreu III “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*” të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil*” dhe të administrojë atë në dosjen e personelit (*dosje individuale*).

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**